| 2. Studentët/et të cilët/at i plotësojnë kushtet dhe kriteret sipas këtij UA, duhet të plotësojnë formularin e aplikimit dhe t'i dorëzojnë dokumentet në vijim në përputhje me formatin e përcaktuar në konkurs: | 2. Students who meet the conditions and criteria according to this AI, must complete the application form and submit the following documents in accordance with the format defined in the competition: | 2. Studenti koji ispunjavaju uslove i kriterijume prema ovom AU, moraju popune obrazac za prijavljivanje i da dostave sledeća dokumenta u skladu sa formatom definisanim konkursom: |
| 2.1. Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës; | 2.1. ID copy of the Republic of Kosova; | 2.1. Kopija lične karte Republike Kosova; |

| | | |
|---|---|---|
| 2.2. Kopjen/konfirmimin e xhirollogarisë bankare personale aktive në Kosovë; | 2.2. Copy/Confirmation of active personal bank account in Kosova; | 2.2. Kopija/potvrda o aktivnom ličnom bankovnom računu na Kosovu; |
| 2.3. Dëshmi/vërtetim nga organet kompetente mbi adresën/vendbanimin e përhershëm në Kosovë. | 2.3. Evidence/certificate from the competent authorities on the address/permanent residence in Kosova. | 2.3. Dokaz/potvrda od strane nadležnih organa o adresi/stalnom prebivalištu na Kosovu. |
| 2.4. Letërpranimin nga institucioni pritës arsimor dhe përgjigjen konfirmuese të studentit/es; | 2.4. Admission letter from the host educational institution and the student's confirming response; | 2.4. Pismo o prijemu od obrazovne institucije domaćina i potvrdni odgovor studenta/ce; |
| 2.5. Letrën motivuese; | 2.5. Cover letter; | 2.5. Motivaciono pismo; |
| 2.6. Pasqyrën e notave të shkollës së mesme/pasqyrën e notave nga Universiteti me notë mesatare dhe ECTS kredi të vitit paraprak; | 2.6. Overview of secondary school grades/overview of grades from the University with average grade and ECTS credits of the previous year; | 2.6. Prepis ocena iz srednje škole/prepis ocena sa Univerziteta sa prosečnom ocenom i ECTS kredita prethodne godine; |
| 2.7. Studentët/et nga viti i dytë e tutje, duhet të sjellin dëshmi/vërtetim mbi statusin aktiv të studentit; | 2.7. Students from the second year onwards, must bring evidence/certification on the student active status; | 2.7. Studenti od druge godine pa nadalje, moraju dostaviti dokaz/potvrdu o aktivnom statusu studenta; |
| 2.8. Kopjen e diplomës të nivelit paraprak të studimit; | 2.8. Copy of the diploma of the preliminary study level; | 2.8. Kopija diplome o prethodnom nivou studija; |
| 2.9. Dokumentet relevante të dorëzuara për aplikim në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyera nga një përkthyes zyrtar në gjuhën zyrtare | 2.9. Relevant documents submitted for application in a foreign language must be translated by an official translator into the relevant official language of the | 2.9. Relevantna dokumenta podneta za prijavu na stranom jeziku moraju biti prevedena od strane zvaničnog prevodioca na relevantni službeni jezik |

| | | |
|---|---|---|
| përkatëse të Republikës së Kosovës. Mund të pranohen nëse janë lëshuar dokumente autentike në gjuhë angleze nga institucioni pritës. | Republic of Kosova. May be accepted if authentic documents in English have been issued by the host institution. | Republike Kosovo. Mogu se prihvatiti ako je institucija domaćin izdala autentična dokumenta na engleskom jeziku. |
| 3. Studentët/et që përfitojnë bursë nga Ministria, duhet të bashkëpunojnë me Ministrinë për çështje të cilat ndërlidhen me studimet e tyre dhe të raportojnë për suksesin. | 3. Students benefiting scholarship from the Ministry must cooperate with the Ministry on issues related to their studies and report on their success. | 3. Studenti koji dobiju stipendiju Ministarstva moraju sarađivati sa Ministarstvom po pitanjima vezanim za njihove studije i da podnesu izveštaj o svom uspehu. |
| 4. Studentët nënshkruajnë Deklaratë të Zotimit që marrin përsipër të promovojnë Kosovën, ndihmojnë në rrjetëzim të studentëve të tjerë dhe mentorojnë të tjerët nëse është nevoja. | 4. Students sign a Declaration of Commitment committing to promote Kosova, helps networking other students and mentor others if needed. | 4. Studenti potpisuju Deklaraciju posvećenosti kojom se obavezuju da će promovisati Kosovo, pomoći u umrežavanju drugih studenata i mentorisati druge ako je potrebno. |
| **Neni 10**<br>**Bursat për studime të doktoratës jashtë vendit** | **Article 10**<br>**Scholarships for doctoral studies abroad** | **Član 10**<br>**Stipendije za doktorske studije u inozemstvo** |
| 1. Kandidatë/et e regjistruar/a në studime të doktoratës jashtë vendit mund të aplikojnë për bursë nëse i plotësojnë kushtet dhe kriteret si në vijim: | 1. Candidates enrolled abroad in doctorate studies can apply for a scholarship if they meet the following conditions and criteria: | 1. Kandidati koji su upisali doktorske studije u inostranstvu mogu se prijaviti za stipednije ako ispunjavaju sledeće uslove i kriterijume: |
| 1.1. Të jenë shtetas/e të Republikës së Kosovës; | 1.1. To be citizens of the Republic of Kosova; | 1.1. Da su državljani Republike Kosovo; |
| 1.2. Të jenë regjistruar në studime të doktoratës jashtë vendit në ndonjë nga 500 universitetet më të mira sipas | 1.2. To have enrolled in doctoral studies abroad in any of the top 500 universities according to the ranking in | 1.2. Da su upisali doktorske studije u inostranstvu na nekom od 500 najboljih univerziteta prema rangiranju na |

| | | |
|---|---|---|
| rangimit në listën Shangai, Times Higher Education apo QS World University Rankings apo ndonjë listë tjetër të përcaktuar me konkurs;<br><br>1.3. Kandidatët/et mund të përkrahen edhe në rastet kur Universiteti ku ata/o janë pranuar nuk figuron në top 500 universitetet më të mira, por dega/fusha e studimit është në listat për rangim të cekura në këtë UA dhe sipas indikatorëve matës për fusha është ndër fushat e 100 universiteteve më të mira në botë dhe është fushë me prioritet kombëtar.<br><br>2. Kandidatët/et duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:<br><br>2.1. CV (jetëshkrimin);<br><br>2.2. Kopjen e letërnjoftimit ose pasaportës së Republikës së Kosovës;<br><br>2.3. Vërtetimin që është pranuar për studime në institucionin përkatës të huaj;<br><br>2.4. Vërtetimin nga punëdhënësi që kandidati/ja nuk ka përkrahje financiare për studime të doktoratës; | the Shanghai, Times Higher Education or QS World University Rankings or any other list determined by competition;<br><br>1.3. Candidates can be supported even in cases where the University does not appear in the top 500 best universities, but the branch/field of study is on the lists for ranking mentioned in this AI and according to the measuring indicators for the field it is among the fields of the 100 best universities in the world and it is a field with national priority.<br><br>2. Candidates must submit these documents:<br><br>2.1. CV (biography);<br><br>2.2. Copy of ID or passport of the Republic of Kosova;<br><br>2.3. Certificate that has been admitted for studies in the relevant foreign institution;<br><br>2.4. Certificate from the employer that the candidate does not have financial support for doctoral studies; | Šangajskoj listi, Times Higher Education ili QS World University Rankings ili bilo kojoj drugoj listi utvrđenoj konkursom;<br><br>1.3. Kandidati mogu biti podržani i u slučajevima kada Univerziteti na kojem su se oni upisali ne figurira u prvih 500 najboljih univerziteta, ali je grana/oblast studija je na listi rangiranja navedenog u ovom AU i prema mernim indikatorima za oblast među 500 najboljih univerziteta u svetu i pripada u oblast od nacionalnog prioriteta.<br><br>2. Kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:<br><br>2.1. CV (biografija);<br><br>2.2. Kopija lične karte ili pasoša Republike Kosova;<br><br>2.3. Potvrda da je primljen na studije u odgovarajućoj stranoj instituciji;<br><br>2.4. Potvrda poslodavca da kandidat/konja nema finansijsku podršku za doktorske studije; |

| | | |
|---|---|---|
| 2.5. Deklaratën nën betim të vërtetuar nga noteri (për kandidatët të cilët nuk janë të punësuar); | 2.5. Declaration under oath certified by the notary (for candidates who are not employed); | 2.5. Izjava pod zakletvom overena kod notara (za kandidate koji nisu u radnom odnosu); |
| 2.6. Dëshminë nga universiteti pritës që kandidati/ja nuk ka mbështetje të plotë financiare nga ky institucion; | 2.6. Evidence from the host university that the candidate does not have full financial support from this institution; | 2.6. Dokaz sa univerziteta domaćina da kandidat nema punu finansijsku podršku ove institucije; |
| 2.7. Dokumentin origjinal të nënshkruar dhe të vulosur nga autoritetet e universitetit si dëshmi për progresin e tyre në program - provimet që i ka kaluar, pjesëmarrjen në projekte hulumtuese shkencore, (vlen për kandidatët/et që janë në vitin e dytë të studimeve e tutje); | 2.7. The original document signed and stamped by the university authorities as proof of their progress in the program - exams passed, participation in scientific research projects, (applies to candidates who are in the second year of studies onwards). | 2.7. Originalni dokument potpisan i overen od strane organa univerziteta kao dokaz o njihovom napredovanju na programu – ispite koje su položili, učešće u naučnoistraživačkim projektima, (odnosi se na kandidate druge godine studija pa nadalje; |
| 2.8. Deklaratën e zotimit që studenti do të promovoj Kosovën, ndihmoj në rrjetëzimin e studentëve të tjerë dhe komunitetit hulumtues dhe bashkëpunimin me Ministrinë me qëllim të promovimit të praktikave të mira evropiane në vend; | 2.8. Declaration of commitment that the student will promote Kosova, help in the networking of other students and the research community and cooperation with the Ministry in order to promote good European practices in the country. | 2.8. Izjavu o posvećenosti da će student promovisati Kosovo, pomoći u umrežavanju drugih studenata i istraživačke zajednice i saradnju sa Ministarstvom u cilju promovisanja dobre evropske prakse u zemlji; |
| 2.9. Në rastet kur buxheti është i kufizuar dhe nuk mund të përkrahen të gjithë/a studentët/et që aplikojnë dhe janë duke studiuar në IAL brenda listës Shangai, Times Higher Education apo QS World University Rankings, përparësi kanë studentët/et që studiojnë | 2.9. In cases where the budget is limited and it is not possible to support all the students who apply and are studying in the HEIs listed in the Shanghai, Times Higher Education or QS World University Rankings, priority is given to students studying in | 2.9. U slučajevima kada je budžet ograničen i nije moguće podržati sve studente koji se prijavljuju i studiraju u IVO navedenim na rang-listi Shangai, Times Higher Education apo QS World University Rankings, prioritet se daje studentima koji studiraju na |

| | | |
|---|---|---|
| në universitetet/fushat e studimeve sipas rangimit në listën Shangai, Times Higher Education apo QS World University Rankings.<br><br>3. Kandidati/ja mund të jetë përfitues më së shumti për tre (3) vite akademike, duke aplikuar çdo vit sipas konkursit të shpallur. Në rastet kur programi i studimeve të doktoratës zgjat më shumë se tri vite akademike, ministria mund të ofroj mbështetje financiare nëse kandidati/ja përmbushë kriteret sipas thirrjes dhe/ose në rastet kur fusha e studimit i përket fushës prioritare.<br><br>4. Dokumentet relevante të dorëzuara për aplikim në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyera nga një përkthyes zyrtar në gjuhën zyrtare përkatëse të Republikës së Kosovës. Dokumentet e lëshuara në gjuhën angleze mund të pranohen.<br><br>5. Ministria nxjerr vendim për përfituesit/et e bursave të doktoratës me të cilat përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë ndërmjet palëve.<br><br>**Neni 11**<br>**Skema të tjera për mbështetje financiare** | universities/ the fields of study according to the ranking in the Shanghai, Times Higher Education or QS World University Rankings<br><br>3. The candidate can be a beneficiary for a maximum of three (3) academic years, applying every year according to the announced competition. In cases where the doctoral study program lasts more than three academic years, the ministry can offer financial support, if the candidate fulfills the criteria according to the call and/or in cases where the field of study belongs to the priority field.<br><br>4. Relevant documents submitted for application in a foreign language must be translated by an official translator into the relevant official language of the Republic of Kosova. Documents issued in English language can be accepted<br><br>5. The Ministry issues a decision on the beneficiaries of doctoral scholarships, which define the duties and responsibilities between the parties.<br><br>**Article 11**<br>**Other schemes for financial student** | univerzitetima/u oblastima. studiranja prema rangiranju na rang-listi Shangai,i, Times Higher Education apo QS World Rankings, .<br><br>3. Kandidat može biti korisnik najviše tri (3) akademske godine, aplicirajući svake godine prema raspisanom konkursu. U slučajevima kada studijski program doktorskih studija traje duže od tri akademske godine, ministarstvo može ponuditi finansijsku podršku ako kandidat/kinja ispunjava kriterijume po pozivu i/ili u slučajevima kada oblast studija pripada prioritetnoj oblasti.<br><br>4. Relevantna dokumenta podneta za prijavu na stranom jeziku moraju biti prevedena od strane zvaničnog prevodioca na relevantni službeni jezik Republike Kosovo. Dokumentiizdati na engleskom jeziku mogu se prihvatiti.<br><br>5. Ministarstvo donosi odluku o korisnicima doktorskih stipendija, kojim se utvrđuju dužnosti i odgovornosti između stranaka.<br><br>**Član 11**<br>**Druge šeme za finansijsku podršku** |

| për studentë | support | studentima |
|---|---|---|
| 1. Ministri/ja e Arsimit, nxjerr vendim edhe për mbështetje për kategori të veçanta në përputhje me politikat dhe prioritetet në nivel kombëtar. | 1. The Minister of Education also issues a decision on support for special categories in accordance with policies and priorities at the national level. | 1. Ministar obrazovanja donosi odluku i o podršci posebnim kategorijama u skladu sa politikama i prioritetima na nacionalnom nivou. |
| 2. Skemat e tilla duhet të përfshijnë mbështetjen e grupeve shoqërore të margjinalizuara apo të nën përfaqësuara të Republikës së Kosovës që ndjekin studimet në institucionet e arsimit të lartë publik. | 2. Such schemes should include the support of marginalized or underrepresented social groups of the Republic of Kosova who attend studies in higher public education institutions. | 2. Takve šeme treba da uključuju podršku marginalizovanim ili nedovoljno zastupljenih društvenim grupa Republike Kosovo koje pohađaju studije u javnim institucijama visokog obrazovanja. |
| 3. Skema duhet të jetë e përcaktuar me vendim të Ministres dhe konkurs publik dhe të ofroj informata mbi kategorinë përkatëse që do të mbështetet siç mund të jenë personat me aftësi të kufizuara, bursa për vajza dhe gra, bursa për burra në programe specifike që ka përfaqësim të vogël siç mund të jenë programet e Edukimit apo tjetër, komunitetet joshumicë, program specifik me prioritet kombëtar, përfaqësim në gara të njohura ndërkombëtare. | 3. The scheme must be determined by decision of the Minister and public competition and provide information on the relevant category that will be supported such as persons with disabilities, scholarships for girls and women, scholarships for men in specific programs that have representation of small, such as Education programs or other, non-majority communities, specific program with national priority, representation in recognized international competitions | 3. Šema mora biti utvrđena odlukom ministra i javnim konkursom i da pruža informacije o relevantnoj kategoriji koja će se podržati kao što su osobe sa ograničenim sposbnostima, stipendije za devojke i žene, stipendije za muškarce u određenim programima kojima je mala zastupljenost kao što može da bude Programi edukacije ili drugih, nevećinskih zajednica, specifični program sa nacionalnim prioritetom, zastupljenost na priznatim međunarodnim takmičenjima. |
| 4. Kriteret e aplikimit, nota mesatare, shuma e mbështetjes financiare, programi i studimit dhe detaje tjera shtesë duhet të jenë pjesë e vendimit dhe konkursit publik.<br>5. Nota mesatare nuk aplikohet gjatë vlerësimit për student me aftësi të kufizuara | 4. Application criteria, grade average, amount of financial support, study program and other additional details should be part of the decision and public competition.<br>5. The average grade is not applied during the assessment for students with | 4. Kriterijumi za prijavu, prosek ocene, visina finansijske podrške, studijski program i drugi dodatni detalji treba da budu deo odluke i javnog konkursa.<br>5. Prosečna ocena se ne primenjuje prilikom ocenjivanja za studente sa |

| | | |
|---|---|---|
| siç është përcaktuar apo përcaktohet me vendim me skemat e tjera dhe përfundimi i provimeve në afat të rregullt akademik nuk është kriter vlerësimi për këtë kategori të aplikuesve.<br><br>6. Studentët/et me aftësi të kufizuara mund të përfitojnë bursë brenda dyfishit të afatit të rregullt të studimeve të paraparë me legjislacionin në fuqi, varësisht nga kohëzgjatja e programit.<br><br>7. Dokumentet e aplikimit duhet të jenë në harmoni me këtë UA dhe me formatin e përcaktuar në konkurs.<br><br>**Neni 12**<br>**Aplikimi për skemat e bursave**<br><br>1. Dokumentet duhet të dorëzohen në formatin e përcaktuar nga Ministria me konkurse publike dhe me këtë UA, të cilat mund të specifikohen më tej me udhëzues plotësues praktik, për sa i përket formës së aplikimit (kopje elektronike ose fizike), formatit të dokumenteve të nevojshme (origjinale apo tjetër).<br><br>2. Ministria mund të kërkojë dokumente shtesë sipas nevojës.<br>3. Dokumentet e pakompletuara do të refuzohen nga komisioni. Dokumente të | disabilities, as defined or determined by decision with other schemes and the completion of exams in the regular academic term is not an assessment criterion for this category of applicants.<br><br>6. Students with disabilities can benefit from a scholarship within twice the regular term of studies provided by the legislation in force, depending on the duration of the program.<br><br>7. The application documents must be in harmony with this AI and with the format defined in the competition.<br><br>**Article 12**<br>**Application for scholarship schemes**<br><br>1. The documents must be submitted in the format determined by the Ministry with public competition and with this AI, which can be further specified with additional practical guidelines, regarding the the application form (electronic or physical copy), the format of the necessary documents (original or other).<br><br>2. The Ministry may request additional documents as needed.<br>3. The commission will reject the incomplete documents. Incomplete | ograničenim sposbnostima kako je definisano ili se definiše odlukom sa drugim šemama i završetak ispita u redovnom akademskom roku nije kriterijum za ocenjivanje za ovu kategoriju kandidata.<br><br>6. Studenti sa ograničenim sposbnostima mogu koristiti stipendiju u dvostrukom trajanju od redovnog roka studija predviđenog važećim zakonodavstvom, u zavisnosti od trajanja programa.<br><br>7. Dokumentacija za prijavu mora biti u skladu sa ovim AU i formatom definisanim u konkursu.<br><br>**Član 12**<br>**Apliciranja za šeme stipendija**<br><br>1. Dokumenta se dostavljaju u formatu koji utvrđuje Ministarstvo javnim konkursom i ovim AU, što se dodatno može precizirati dodatnim praktičnim uputstvima, što se tiće forme prijave (elektronska ili fizička kopija), formata potrebnih dokumenta (original ili drugi).<br><br>2. Ministarstvo po potrebi može zatražiti dodatna dokumenta.<br>3. Ne kompletirana dokumenta komisija će biti odbiti. Nepotpuni dokumenti su: |

| | | |
|---|---|---|
| pakompletuara janë:<br><br>3.1. Mungesa e dokumenteve të kërkuara sipas thirrjes;<br><br>3.2. Dokumentet e dorëzuara/ngarkuara pjesërisht (të cilave u mungojnë faqet);<br><br>3.3. Dokumentet e panënshkruara, pavulosura dhe të pa protokolluara nga institucioni përkatës. | documents are:<br><br>3.1. Lack of documents required by the call;<br><br>3.2. Partially submitted/uploaded documents (which are missing pages);<br><br>3.3. Documents not signed, sealed and not recorded by the relevant institution. | 3.1. Nedostatak dokumenata potrebnih prema pozivu;<br><br>3.2. Delimično predati/ubaćeni dokumenti (kojima nedostaju stranice);<br><br>3.3. Dokumenti koji nisu potpisani, nemaju pečat i nisu protokilsani od strane relevantne institucije. |
| 4. Aplikimet me gabime/lëshime teknike nga ana e aplikuesve në dorëzimin/ngarkimin e dokumenteve do të refuzohen nga komisioni.<br><br>5. Dokumentet e dorëzuara në Ministri nuk kthehen, përkatësisht asgjësohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.<br><br>6. Aplikuesit/et të cilët/at dorëzojnë dokumente me përmbajtje të pavërtetë dhe ofrojnë të dhëna të rrejshme nga ato që figurojnë në dokumentet zyrtare do të eliminohen automatikisht nga konkursi dhe mund të ju mohohet e drejta për aplikimet e radhës.<br>7. Aplikuesit nuk mund të jenë përfitues të bursës nga më shumë se një skemë e | 4. Applications with errors/technical omissions by the applicants in submitting/uploading documents, will be rejected by the commission<br><br>5. The documents submitted to the Ministry are not returned respectively destroyed in accordance with the legislation in force.<br><br>6. Applicant/s submitting documents with false content and provide false data from those appearing in official documents will be automatically eliminated from the competition and may be denied the right to further applications.<br><br>7. Applicants cannot be beneficiaries of the scholarship from more than one | 4. Prijavljivanje sa tehničkim greškama/propustima od strane podnosilaca prijava u podnošenju/ubacivanju dokumenata komisija će odbaciti.<br><br>5. Dokumenti dostavljeni Ministarstvu se ne vraćaju, odnosno uništavaju u skladu sa važećim zakonodastom.<br><br>6. Kandidati koji dostave dokumenta sa lažnim sadržajem i navedu lažne podatke od onih koji figuriraju u zvaničnim dokumentima biće automatski eliminisani sa konkursa i njima može biti uskraćeno pravo za dalje prijave.<br><br>7. Kandidati ne mogu biti korisnici stipendije iz više od jedne šeme stipendija |

| | | |
|---|---|---|
| bursave nga Ministria brenda të njëjtit vit akademik. | scholarship scheme from the Ministry within the same academic year. | Ministarstva u istoj akademskoj godini. |
| **Neni 13**<br>**Procedurat e vlerësimit** | **Article 13**<br>**Evaluation procedures** | **Član 13**<br>**Procedura ocenjivanja** |
| 1. Për shqyrtimin e aplikimeve për bursa për studime në nivelin BA dhe MA brenda dhe jashtë vendit, Ministri/ja formon komisione të veçanta vlerësuese dhe përzgjedhëse. | 1. For applications scholarship review for studies at the BA and MA level inside and outside the country, the Minister forms special evaluation and selection committees. | 1. Za razmatranje zahteva za stipendije za studije na BA i MA nivou u zemlji i van nje, ministar/ka formira posebne komisije za evaluaciju i izbor. |
| 2. Komisionet kanë përgjegjësi për administrimin e procesit të konkursit, shqyrtimin e aplikacioneve, hartimin e raporteve (vlerësimeve, konstatimeve dhe rekomandimeve), të cilat nënshkruhen dhe i dërgohen ministrit/es brenda 30 ditëve nga dita e mbylljes së konkursit. | 2. The commissions are responsible for administering the competition process, reviewing applications, compiling reports (assessments, findings and recommendations), which are signed and sent to the minister within 30 days from the day the competition closes. | 2. Komisije su odgovorne za upravljanje procesa konkurisanja, razmatranje aplikacija, izveštaja (ocenjivanja, konstatacije i preporuke) potpisane šalju ministru/ke u roku od 30 dana od dana zatvaranje konkursa. |
| 3. Ministria në mbështetje të këtij UA, përgatitë udhëzues praktik që ofron informata plotësuese mbi procedurat e aplikimit, vlerësimit, rolit të komisioneve. | 3. The Ministry, in support of this AI, prepares a practical guide that provides additional information on application procedures, assessment and the role of commissions. | 3. Ministarstvo, shodno ovom AU, priprema praktičan vodič koji pruža dodatne informacije o procedurama prijavljivanja, proceni i ulozi komisija. |
| 4. Përgjegjësitë tjera të Komisionit të veçantë mund të përcaktohen në vendimin për themelimin e tij, të cilin e nxjerr ministri/ja.<br>5. Vendimin për ndarjen e bursës për studime brenda dhe jashtë vendit e merr | 4. Other responsibilities of the special Commission can be determined in the decision on its establishment, which is issued by the minister.<br>5. The decision on the allocation of the scholarship for studies inside and outside | 4. Ostale odgovornosti Posebne komisije mogu biti utvrđene u odluci o njenom osnivanju, kojeg se donosi ministar/ka.<br>5. Odluku o dodeli stipendije za studije u zemlji i van nje donosi ministar/ka, na |

| | | |
|---|---|---|
| ministri/ja, në bazë të raportit të dorëzuar nga komisioni përkatës. Përjashtim bën paragrafi 8 i këtij neni. | the country is taken by the minister, based on the report submitted by the relevant commission. Paragraph 8 of this article is an exception. | osnovu izveštaj koji dostavi nadležna komisija. Izuzetak je stav 8. ovog člana. |
| 6. Vendimi për përfituesit/et e përcaktuar/a në skemën sipas nenit 12 të këtij UA, do të merret varësisht nga natyra e mbështetjes financiare që do të ofrohet dhe procedura administrative që do të ndiqet për skemën përkatëse. | 6. The decision for the beneficiaries defined in the scheme according to Article 12 of this AI will be taken depending on the nature of the financial support that will be offered and the administrative procedure that will be followed for the respective scheme. | 6. Odluka za korisnike definisana u šemi u skladu sa članom 12. ovog AU biće doneta u zavisnosti od prirode finansijske podrške koja će biti ponuđena i administrativne procedure koja će biti propraćene za dotičnu šemu. |
| 7. Zhvillimi i procedurave për ofrimin e bursave për studime të doktoratës brenda dhe jashtë vendit bëhet nga Këshilli i Shkencës i Ministrisë (KSH). KSH ka përgjegjësi për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve, hartim të raporteve (vlerësimeve, konstatimeve dhe rekomandimeve), të cilat nënshkruhen dhe i dërgohen sekretarit/es të Ministrisë brenda 30 ditëve nga dita e mbylljes së konkursit. | 7. The development of procedures for offering scholarships for doctoral studies in the country and abroad is done by the Science Council of the Ministry (SC). The SC is responsible for reviewing and assessing applications, compiling reports (assessments, findings and recommendations), which are signed and sent to the secretary of the Ministry within 30 days from the day the competition closes. | 7. Razvijanje procedura za dodelu stipendije za doktorske studije u zemlji i inostranstvu vrši Naučni savet Ministarstva (NS). NS je odgovorna za razmatranje i procenu aplikacija, izradu izveštaja (ocenjivanja, konstatacije i preporuke) koje se potpisuju i šalju sekretaru/ke ministarstva u roku od 30 dana od dana zatvaranja konkursa. |
| 8. Vendimin për bursa të doktoratës, e merr sekretari/ja i/e Ministrisë, bazuar në raportin e KSH. | 8. The decision on doctoral scholarships is taken by the secretary of the Ministry based on the report of the SC. | 8. Odluka za stipendije za doktorat donosi sekretar/ka u ministarstvu na osnovu izveštaja NS |
| 9. Ministria publikon vendimet për përfituesit/et e bursave për të gjitha nivelet e studimeve brenda dhe jashtë vendit në | 9. The Ministry publishes the decisions for the beneficiaries of the scholarships for all levels of studies in the country and abroad | 9. Ministarstvo objavljuje odluke za korisnike stipendija za sve nivoe studija u zemlji i inostranstvu na zvaničnoj internet |

| | | |
|---|---|---|
| faqen zyrtare të ministrisë.<br><br>10. Ministria ka të drejtë të largojë nga vendimi përfituesit/et e shpallur, në rast të gjetjes së ndonjë shkelje eventuale nga aplikuesi, të thirrjes publike të shpallur nga MASHTI.<br><br>**Neni 14**<br>**E drejta e ankesës**<br><br>1. Aplikuesit/et e pakënaqur/a, kanë të drejtë ankese brenda 7 (shtatë) ditëve pas shpalljes së rezultateve, në Komisionin për ankesa dhe parashtresa në ministri.<br><br>2. Komisioni për ankesa dhe parashtresa në ministri, vendos për ankesa brenda 15 ditëve pas mbylljes së afatit të ankesave.<br><br>3. Vendimi i këtij komisioni është përfundimtar në procedurë administrative.<br><br>**Neni 15**<br>**Dispozitat shfuqizuese** | on the official website of the Ministry.<br><br>10. The Ministry has the right to remove the announced beneficiary/ies from the decision, in case of finding any possible violation of the public call announced by MESTI.<br><br>**Article 14**<br>**Right to Appeal**<br><br>1. Dissatisfied applicants have the right to appeal within 7 (seven) days after the announcement of the results, to the Commission for Complaints and Submissions at the Ministry.<br><br>2. The Commission for Complaints and Submissions to the Ministry decides on complaints within 15 days after the deadline for complaints.<br><br>3. The decision of this commission is final in the administrative procedure.<br><br>**Article 15**<br>**Repealing provisions** | stranici Ministarstva.<br><br>10. Ministarstvo ima pravo da ukloni sa odluke najavljene korisnike/ce, u slučaju da utvrdi eventualnu povredu javnog poziva koji je raspisao MONTI.<br><br>**Član 14**<br>**Pravo na žalbu**<br><br>1. Nezadovoljni kandidati imaju pravo žalbe u roku od 7 (sedam) dana nakon objavljivanje rezultata, Komisiji za žalbe i podneske u ministarstvo.<br><br>2. Komisija za žalbe i podneske u Ministarstvu odlučuje o žalbama u roku od 15 dana od isteka roka za podnošenje žalbi.<br><br>3. Odluka Ministarstva je konačna u upravnom postupku.<br><br>**Član 15**<br>**Van snažne odredbe** |

| | | |
|---|---|---|
| **Neni 15**<br>**Dispozitat shfuqizuese** | **Article 15**<br>**Repealing provisions** | **Član 15**<br>**Van snažne odredbe** |
| Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi administrativ, shfuqizohet Udhëzimi administrativ: Kriteret, procedurat dhe kategorite e studentëve përfitues të bursave nga MASHT-i për studime jashtë vendit nr. 32/2009, dt. 15.09.2009 dhe Udhëzimi administrativ për ndarjen e bursave nr. 14/2017, dt. 06.12.2017. | With entry into force of this Administrative instruction is repealed the Administrative instruction: Criteria, procedures and categories of students receiving scholarships from MEST for studies abroad no. 32/2009, dated 15.09.2009 and with the Administrative Instruction no. 14/2017, dated 06.12.2017. | Stupanjem na snagu ovog Administrativnog uputstva, stavlja se van snage Administrativno uputstvo: Kriterijumi, procedure i kategorije studenata koji primaju stipendije MONT-a za studije u inostranstvu br. 32/2009, dat. 15.09.2009 i Administrativno uputstvo za dodelu stipendija br. 14/2017, dat. 06.12.2017. |
| **Neni 16**<br>**Hyrja në fuqi** | **Article 16**<br>**Entry into force** | **Član 16**<br>**Stupanje na snagu** |
| Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit të tij në Gazetën zyrtare. | This Administrative Instruction enters into force seven (7) days after being published in the official gazette. | Ovo Administrativno Uputstvo stupa na snagu sedam (7) dana nakon objavljivbanje u službenom glasniku. |
| **Arbërie Nagavci**<br>__________<br>**Ministre**<br>**Dt.** 04.08.2023 | **Arbërie Nagavci**<br>__________<br>**Minister**<br>**Date.** ____.____.______ | **Arbërie Nagavci**<br>__________<br>**Ministarka**<br>**Dat.** ____.____.______ |